



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1050

Paneli Shqyrtues, i emëruar në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani, panelist individual duke vendosur sipas ankesës së OE “Eco Amari” SH.P.K. kundër Njoftimitin e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shprehje interesi – shërbime të tërheqjes apo bllokimit të automjeteve sipas urdhëresës së Policisë së Kosovës ” me numër të prokurimit:634-25-8413-2-6-10, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Klinës më 02/12/2025, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e OE “Eco Amari” SH.P.K. me nr. 2025/1050, e datës 23/10/2025 lidhur me aktivitetin e ankandit publik me titull “Shprehje interesi – shërbime të tërheqjes apo bllokimit të automjeteve sipas urdhëresës së Policisë së Kosovës ” me numër; 634-25-8413-2-6-10, inicuar nga autoriteti kontraktues AK-Komuna Klinë.
2. Mbetet në fuqi, Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, AK -Komuna Klinë, për aktivitetin e ankandit publik me të dhënat si në pikën një (1) të vendimit.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues OE “Eco Amari” SH.P.K, konfiskohet tarifa e sigurimit ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Klinës cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shprehje interesi – shërbime të tërheqjes apo bllokimit të automjeteve sipas urdhërësës së Policisë së Kosovës ” me numër të prokurimit: 634-25-8413-2-6-10.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë e hapur me llojin e kontratës shërbim .

Me 19.10.2025 OE “Eco Amari” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim

Me 23.10.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Eco Amari” SH.P.K. me nr. 1050/2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shprehje interesi – shërbime të tërheqjes apo bllokimit të automjeteve sipas urdhërësës së Policisë së Kosovës ” me numër të prokurimit: 634-25-8413-2-6-10.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Eco Amari” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

PRETENDIMI Nr. 1

Duke u bazuar në kushtet e njoftimit për kontratë, si dhe dosjen e tenderit të publikuar nga AK në e-prokurim, pika 21.1 Kriteret e Dhënies, kriteri i dhënies së kontratës ka qenë çmimi më i lartë. Ndërsa vetë AK, në vlerësimin e ofertave, ka vepruar në kundërshtim me Nenin 27 të Dosjes së Tenderit, si dhe Nenin 54 Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar, pika 2, si dhe Nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve dhe Nenin 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, duke favorizuar qartësisht dhe propozuar për shpërblyer operatorin ekonomik me çmimin më të ulët, duke vepruar në kundërshtim të plotë me Dosjen e Tenderit dhe LPP.

Vetë AK ka përcaktuar përmes dosjes së tenderit kriteret e dhënies së kontratës, konkretisht dhënien me çmimin më të lartë. Ndërsa në letrat standarde për OE të suksesshëm dhe të pasuksesshëm, OE i propozuar për shpërblyer me kontratë është propozuar për arsye se ka ofruar çmimin më të ulët. Po me të njëjtën arsye, oferta jonë është refuzuar, meqë është shpërblyer OE me çmimin më të ulët. Atëherë lind pyetja: në bazë të cilit dokument ka realizuar AK vlerësimin e ofertave tona dhe mbi ç’arsyetim e ka cilësuar ofertën tonë si të pasuksesshme. Kështu, AK ka kryer shkelje flagrante të LPP dhe rregulloreve në fuqi.

Përveç që AK nuk ka vepruar në përputhje me DT dhe kushtet e saj, ka vepruar gjithashtu në kundërshtim me LPP, Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, pasi OE i propozuar për shpërblyer me kontratë pothuajse nuk i mbulon kërkesat e FTD dhe është i

papërgjegjshëm administrativisht.

AK, në përgjigjen ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim të datës 17.09.2025, të paraqitur përmes e-prokurimit, e refuzon kërkesën tonë lidhur me llojin e DT, ku ndër të tjera thotë:

“Pas shqyrtimit të plotë të pretendimeve tuaja dhe konsultimit me KRPP, si dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik, autoriteti kontraktues konfirmon se zgjedhja e procedurës së ankandit publik është bërë mbi bazën e analizës së interesit publik dhe përfitimeve financiare që kjo procedurë sjell për autoritetin kontraktues.

Procedura e ankandit publik është vlerësuar si më e përshtatshme në këtë rast për arsyet si vijon:

1. Efikasiteti financiar: Ankandi publik krijon kushte konkurruese që zakonisht rezultojnë në të ardhura më të larta për autoritetin kontraktues, sidomos në rastet e dhënies me qira, shitjes së pasurive ose të drejtave të caktuara.
2. Transparenca dhe konkurrenca: Kjo procedurë garanton proces të hapur dhe transparent, ku operatorët ekonomikë kanë mundësinë të marrin pjesë në mënyrë të barabartë.
3. Përshtatshmëria me objektin e kontratës: Duke pasur parasysh natyrën e objektit në këtë rast, procedura e ankandit është ligjërisht e lejuar dhe në përputhje të plotë me qëllimet e autoritetit kontraktues.
4. Lidhur me kapacitetin ekonomik është bërë përmirësimi përkatës.”

Lind pyetja: si ka mundësi që AK nuk merr për bazë as Dosjen e Tenderit të publikuar nga vetë ai, as Ligjin e Prokurimit Publik, as përgjigjen e vet ndaj kërkesës sonë paraprake për rishqyrtim — ku arsyetohet se ankandi publik krijon të ardhura më të larta për autoritetin — ndërsa në të njëjtën kohë tenton të favorizojë OE të propozuar, i cili ka ofruar çmimin më të ulët se ne, gjë që rezulton në të ardhura më të ulëta për AK.

PRETENDIMI Nr. 2

OE i propozuar për shpërblim me kontratë nuk e ka plotësuar Aneksin 2 – Deklarata nën Betim në formën e përcaktuar sipas Dosjes së Tenderit, gjë që e bën ofertën e këtij OE administrativisht të papërgjegjshme.

Sipas kërkesës së DT, Aneksi 2 – Deklarata nën Betim duhet të plotësohet plotësisht dhe saktë. Dokumenti i paraqitur nga OE i propozuar për shpërblim nuk është në përputhje me formatin standard, nuk përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe paraqet mospërputhje formale që bien ndesh me kërkesat minimale të përgjegjshmërisë administrative.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht Nenin 3 të Informacionit për Tenderuesit, dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marr pjesë në këtë procedurë.

Unë pranoj mundësinë e sanksioneve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë, për shkak të pakujdesisë, dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban të dhëna të pasakta ose mashtruese.

PRETENDIMI Nr. 3

OE i propozuar për shpërblim me kontratë, lidhur me **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (projektet e ngjashme)**, ka paraqitur një kontratë të lidhur me Komunën e Klinës (Kontrata publike – Komiza nr. 08/2022, nr. identifikues 634-22-008-221), për të cilën ka

paraqitur referencë të lëshuar nga Komuna e Klinës, respektivisht **Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente**, Nr. 08.221-32746/2025, të datës **26.09.2025**.

Kjo datë është **pas datës së publikimit të njoftimit për kontratë**, çka bie në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit, ku Operatorit Ekonomik i kërkohet të ofrojë dëshmi se ka realizuar projekte të ngjashme **në periudhën e 36 muajve të fundit PARA datës së publikimit të njoftimit për kontratë**.

Në këtë aktivitet prokurimi, data e publikimit të njoftimit për kontratë është **12.09.2025**.

Kjo referencë e paraqitur nga OE i propozuar për shpërblim është **e pavlefshme** për këtë aktivitet prokurimi, pasi:

- Nuk i përmbush kërkesat e DT për projekte të ngjashme të realizuara brenda **36 muajve para datës së publikimit të njoftimit për kontratë**,
- Është lëshuar **pas datës së njoftimit për kontratë**,
- Nuk mund të merret si provë e vlefshme e përvojës së mëparshme sipas kërkesave ligjore dhe administrative.

Si rrjedhojë, OE i propozuar nuk e mbulon kërkesën teknike të përcaktuar nga AK dhe duhet të konsiderohet **administrativisht dhe teknikisht i papërgjegjshëm**.

PRETENDIMI Nr.4

Lidhur me kërkesën e AK ku Operatori Ekonomik duhet të ketë se paku 3 automjete për bartje të peshave të renda deri në 7.5 tone Automjet I lejuar për shërbime të ngjashme të specifikura në Libreze , ku njëra nga këto automjete duhet të jetë e paisur me krane , OE i propozuar ka paraqitur kamion me targa 03-313-JC me peshë 11,900 KG sipas librezës së prezantuar ku është në kundërshtim me kërkesën e përcaktuar nga AK , ku pesha maksimale duhet të jetë 7.5 tonë.

Po ashtu OE ka prezantuar kamionetë me targa 03-768-ID me pronar Pranvera Maloku B.I. sipas librezës së prezantuar ku për të njëjtën nuk ka paraqitur marrëveshje huazimi apo kontratë qiradhënie dhe kjo e bën këtë pajisje të pavlefshme për përdorim në këtë aktivitet prokurimi. OE nuk e ka përmbushur kërkesën e AK të përcaktuar në DT lidhur me pajisjet.

PRETENDIMI Nr. 5

OE i propozuar për shpërblim, në dokumentacionin e tenderit, ka ofruar parcelën me nr. P-71011066-00202-2, ZK Zajm, Komuna Klinë, e cila sipas vetë certifikatës së pronësisë së ofruar nuk është në pronësi të AIM SH.P.K., dhe nuk është paraqitur as kontratë huazimi apo kontratë qiramarrjeje.

Për më tepër, pas verifikimit në Gjeoportalin e Republikës së Kosovës, është vërejtur se kjo parcelë, me numrin e lartpërmendur, nuk ekziston fare.

Gjithashtu, është prezantuar një kontratë noteriale LRP nr. 2099/2025, Ref. Nr. 465/2025, përmes së cilës, siç duket, është tentuar të vihet në lajthitje AK, pasi nga përmbajtja e saj rezulton që bëhet fjalë për një pronë krejtësisht tjetër.

1.1. Shitësit, në bazë të Certifikatës së Pronës nr. 11-2675-2025, datë 09.09.2025, evidentohen si bashkëpronarë, secili me nga 1/2 të vëllimit të pronësisë, në paluajtshmërinë – parcelën me numër P-71011066-00202-3, me sipërfaqe 1091 m², Zona Kadastrale Zajm, vendi i quajtur Llugat, shfrytëzimi i parcelës: Bujqësore – Kullosat, kullosë e klasës së 2-të.

Edhe nëse kjo pronë do të ishte relevante dhe do të përputhej me kërkesat e DT-së, ajo ende nuk është pronë e AIM SH.P.K., pasi:

- nuk është prezantuar certifikata e pronësisë në emër të OE,
- kontrata e prezantuar mund të jetë e papërbushur,
- sipas Nenit 4 të kontratës, pagesa e plotë e çmimit të shitblerjes është e paraparë deri më 31.12.2026, duke e bërë transferimin e pronës ende të papërfunduar.

Në lidhje me pronën e lartpërmendur, OE ka prezantuar edhe foto të një lokacioni me rrethojë dhe kabinë për roje, të cilat nuk i përkasin asnjërës prej pronave të prezantuara në dokumentacion.

Është e pakuptimtë se si AK e ka marrë këtë kërkesë si të përmbushur, kur nga dokumentacioni i paraqitur:

- ose me qëllim,
- ose për shkak të pakujdesisë,

OE ka tentuar të mashtrojë ose të vërë në lajthitje AK, duke paraqitur tre dokumente të ndryshme, të cilat nuk përputhen mes vete dhe nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën lidhur me pronën e kërkuar për ruajtjen e veturave.

PRETENDIMI Nr. 6

Fatura blerëse e paraqitur nga NT “Raci” është e modifikuar ose e pavlefshme, pasi numri unik i identifikimit është i njëjtë si për blerësin, ashtu edhe për shitësin — dhe në asnjë rast nuk përkon me numrat fiskalë/unikë të AIM SH.P.K.

OE i propozuar për shpërblim, lidhur me kërkesën e DT:

- Minimum 5 kompletësh dëshmi për kompletësh bllokuese të automjeteve
- Fatura e blerjes si dhe dëshmi fotografike

ka ofruar një faturë blerjeje të lëshuar nga NT RACI, e cila pas analizimit rezulton të jetë e modifikuar nga vetë OE ose të paktën e pavlefshme, për arsye se:

- numri identifikues i blerësit nuk i përket OE AIM SH.P.K.,
- po ashtu as numri fiskal nuk është i AIM SH.P.K.

Nga të dhënat e mësipërme vërehet qartë se:

- Numri identifikues dhe numri fiskal i blerësit janë identik me të shitësit,
- AIM SH.P.K. nuk figuron me këta numra, duke e bërë dokumentin të pavlefshëm,
- Fatura bie ndesh me legjislacionin tatimor dhe fiskal, duke mos mundur të konsiderohet si dëshmi valide e blerjes.

PRETENDIMI Nr. 7

Lidhur me kërkesën e DT për rojë në lokacion, OE i propozuar për shpërblim nuk ka prezantuar dy rojë fizikë sipas kërkesës.

OE ka prezantuar vetëm një rojë fizik, Muhamet Bajrami, kontrata e të cilit fillon nga data 01.01.2025. Megjithatë, nga lista e prezantuar nga ATK për vitin 2025, rezulton se ky punonjës nuk figuron fare si i deklaruar, çka tregon se kontrata e paraqitur është jo valide dhe nuk përmbush kriteret e DT-së.

Dokumentacioni i bashkëngjitur

- Lista e punëtorëve të deklaruar në ATK për vitin 2025 nga kompania AIM SH.P.K., ku Muhamet Bajrami nuk figuron, duke konfirmuar mos-përputhshmërinë me kërkesën e tenderit.

PRETENDIMI Nr. 8

Paramasa dhe parashikimi financiar i OE i propozuar për shpërblim është **në kundërshtim me Dosjen e Tenderit (DT)** dhe dokumentet përbërëse të saj, si dhe **në kundërshtim me Rregulloren Nr. 01-Nr.052-5227/2018**, datë 02.08.2018, të miratuar nga **Kuvendi Komunal i Klinës**.

Në vetë paramasën e OE, përmendet:

“Pozicionet dhe tarifat për bllokimin dhe zhvendosjen e automjeteve janë marrë nga rregullorja për kushtet dhe mënyrën e bllokimit dhe zhvendosjes së automjeteve, bazuar në Nen 18 të Rregullores së miratuar nga Kuvendi i Komunës së Klinës, Nr. 01-Nr.052-5227/2018, datë 02.08.2018.”

Nëse AK pohon se pozicionet dhe tarifat janë marrë nga kjo rregullore, lind pyetja **logjike**: Si mund të shpërblehet OE që ka ofruar **çmime në kundërshtim me rregulloren dhe DT**?

Tarifat për bllokimin dhe zhvendosjen e automjeteve:

1. Bllokimi i automjetit brenda qytetit: **20 €**
2. Zhvendosja e automjetit brenda qytetit: **30 €**
3. Zhvendosja e kombibuesve dhe xhipeve: **40 €**
4. Bllokimi i kamionit dhe autobusit brenda qytetit: **30 €**
5. Zhvendosja e kamionit dhe autobusit brenda qytetit: **70 €**
6. Për bllokim dhe zhvendosje të automjeteve nga zonat jashtë qytetit, përveç tarifës përkatëse, aplikohet **tarifa shtesë 0,25 € për km kthim**
7. Në rast se pronari ose shfrytëzuesi kërkon lirimin e automjetit para përfundimit të transferimit
8. Në rast se automjeti i zhvendosur nuk tërhiqet brenda **48 orëve**, për çdo 24 orë paguhet tarifa **8 €**

Siç shihet, OE i propozuar për shpërbllim **jo vetëm që nuk i plotëson kërkesat e DT dhe FTD**, por ofertat e tij janë **plotësisht në kundërshtim me rregulloret në fuqi**. Lind pyetja legjitime se si AK mund të tentojë të favorizojë një OE të papërgjegjshëm administrativisht dhe me ofertë që nuk përputhet me kriteret e përcaktuara.

Në vijim, tabela e detajuar e krahasimit të çmimeve **tregon qartë se oferta jonë është më e favorshme për AK**, bazuar në kriterin e çmimit më të lartë.

Për këtë arsye, **AK duhet të na shpallë neve fitues**, dhe jo të bëjë vlerësim në bazë të çmimeve të ofruara nga OE i propozuar, të cilat nuk respektojnë DT dhe rregulloret përkatëse.

PRETENDIMI Nr. 9

Pretendimet tona ankimore, të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të datës 19.10.2025, përmes përgjigjes (vendimit të AK) të datës 21.10.2025, nuk janë trajtuar fare. Autoriteti Kontraktues (AK) as nuk i ka marrë në konsideratë, as nuk ka bërë përpjekje për t'i shqyrtuar ato. Përgjigjet që AK ka dhënë ndaj pretendimeve tona duket se janë lojëra fjalësh, të cilat janë kundërthënëse dhe të pakuptimta.

Shembuj nga përgjigjet e mangëta të AK-së:

1. Përgjigje për OE:

“Pas kalkulimit të ofertës së OE të propozuar për kontratë, kalkulohet se përqindja më e lartë për Autoritetin Kontraktues.”

2. Përgjigje në pretendimin ankimor pika 3:

“Referenca për kontratën e lidhur nga AK Klinë është përmbushur sipas kërkesave të kontratës.”

Nga këto përgjigje të mangëta dhe të pakuptimta, del qartë se AK nënkupton se Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik i Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nuk është i zbatueshëm për autoritetin kontraktues në këtë rast. Po të ishim duke ofertuar në një AK tjetër, referenca nuk do të konsiderohej valide, ndërsa në AK Klinë ajo është pranuar si e vlefshme.

Gjithashtu, përgjigja e AK-së për pretendimin ankimor nr. 5 nuk adreson faktin se OE ka prezantuar tri dokumente të ndryshme, të cilat nuk lidhen me të njëjtën pronë. Për më tepër:

- Prona e përmendur nuk ekziston fare në Gjeoportali,
- Pronë e paraqitur në foto nuk është parcela e deklaruar, por një parcelë tjetër me nr. P-71010027-01822-1 në ZK Dresnik, ku përmes Gjeoportalit shihet qartë vendi ku OE ka mbajtur automjetet dhe ku është vendosur kabina për roje.

Edhe pse AK e di këtë fakt, përsëri vepron në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, duke tentuar të arsyetojë OE, çka tregon favorizim të OE të caktuar.

Kërkesë për veprim nga OSHP

Bazuar në Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (Versioni i Konsoliduar), Neni 97, kërkojmë që:

- Shkeljet e rënda të shqyrtohen nga Komisioni,
- Të vlerësohet dhe të konfirmohet favorizimi i OE dhe mosrespektimi i kriterëve të DT dhe LPP nga AK.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 30/10/2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1050/2025, ndërsa me datë 14/11/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1050 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e “Eco Amari” SH.P.K. eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2025/1050 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigjeje në pretendimin ankimor 1. Eksperti shqyrtues jep mendimin e tij në lidhje me pretendimin ankimor, pasi ka administruar dhe shqyrtuar me kujdes shkresat që lidhen me faktet dhe argumentet në platformën elektronike e – prokurimi, duke u bazuar në pretendimin ankimor të ngritur nga Operator ekonomik (OE) ankues Eco Amari SH.P.K.”- Fushë Kosovë e që ndërlidhet me FDT konkretisht me Kriteret e Dhënies 21.1 paraprakisht bëjë të ditur se në harmoni me neni 59 të LPP-së ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është përgjegjësi ekskluzive e komisionit të vlerësimit /Autoritetit kontraktues.

Më tej sqarojmë....

Duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik ankues, si dhe në përmbajtjen e dosjes së aktivitetit të prokurimit të publikuar në platformën elektronike të e-prokurimit, është shqyrtuar pretendimi që lidhet me mënyrën e përcaktimit të përqindjes që i takon Komunës.

Nga shqyrtimi i dokumenteve rezulton se Autoriteti Kontraktues, në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit, ka përcaktuar strukturën orientuese për përqindjen që i dedikohet Komunës, duke përcaktuar një kornizë të qartë referuese për këtë procedurë.

Në këtë drejtim, ofertuesve të procedurës së ankandit iu është dhënë mundësia që, në ofertat e tyre financiare, të propozojnë përqindjen më të favorshme për Komunën (më të lartë), në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Ky përcaktim është në përputhje me parimet e transparencës dhe konkurrencës së drejtë, duke i mundësuar Komunës të përfitojë nga oferta më e leverdishme ekonomike dhe më e përshtatshme për interesin publik.

Përgjigjeje në pretendimin ankimor 2, Eksperti shqyrtues jep mendimin e tij në lidhje me pretendimin ankimor, pasi ka administruar dhe shqyrtuar me kujdes shkresat që lidhen me faktet dhe argumentet në platformën elektronike e – prokurimi, duke u bazuar në pretendimin ankimor të ngritur nga Operator ekonomik (OE) ankues, e që ndërlidhet me Aneksi 2 Deklaratën Nën Betim sipas DT-së.

Sa i përket pretendimit të parashtruar që ndërlidhet me Aneksin 2 – Deklaratën nën betim, sqarojmë se deklarata në fjalë përmban të gjitha elementet thelbësore të parapara me nenin 65 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Në këtë drejtim, mungesa e shënimit të emrit të operatorit ekonomik në pjesën e sipërme të dokumentit nuk cenon vlefshmërinë juridike të deklaratës dhe as nuk e bën atë dokument të paqëndrueshëm në aspektin ligjor, përderisa përmbajtja e saj është e plotë dhe identifikon qartësisht operatorin ekonomik deklarues, duke u bazuar në sqarimet e lartë përmendura pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Përgjigjeje në pretendimin ankimor 3. Në cilësinë e ekspertit shqyrtues, sqarojmë se lidhur me trajtimin e këtij pretendimi ankimor, me datën 10.11.2025 është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) ofrimi i sqarimeve shtesë, për qëllim të verifikimit të plotë të pretendimit të ngritura nga operatori ekonomik ankues, me datën 12.11.2025, Autoriteti Kontraktues ka dorëzuar përgjigjen, duke ofruar si dokumentacion mbështetës vendimin për caktimin e menaxherit të kontratës, kontratën e lidhur, si dhe policën e sigurimit të ekzekutimit të kontratës si dëshmi se kur ka filluar ekzekutimi i kësaj kontrata dhe kur ka përfunduar kontrata e cila ndërlidhet me referencën ku është ngrit pretendimi ankimor.

Megjithëse dokumentacioni i paraqitur vërteton ndërmarrjen e veprimeve administrative nga ana e AK-së, vërehet se përgjegjësia për qartësinë, kohëshmërinë dhe përputhshmërinë e dokumenteve me kërkesat ligjore dhe dosjen e tenderit mbetet tërësisht në kompetencë të Autoritetit Kontraktues. Bazuar në dokumentacionin plotësues të paraqitur nga Autoriteti Kontraktues dhe në shqyrtim të saj, pretendimi i operatorit ekonomik ankues është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 4: Pretendimi ankimor i ngritur nga operatori ekonomik “Eco Amari” SH.P.K., i cili ndërlidhet me kërkesën e FDT-së që përcakton se *Operatori ekonomik duhet të ketë së paku 3 automjete për bartje të peshave të rënda deri në 7.5 tonë, automjete të lejuara për shërbime të ngjashme të specifikuara në librezë, ku të paktën njëra prej tyre duhet të jetë e pajisur me kran*, është shqyrtuar duke u mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik dhe në dosjen e aktivitetit të prokurimit të ankandit publik në platformën elektronike të e-prokurimit.

Nga analiza rezulton se operatori ekonomik ka ofruar automjete për bartjen e peshave të rënda, mirëpo vlerësimi i përmbushjes së kërkesës teknike në këtë rast bie drejtpërdrejt në kompetencë dhe përgjegjësi të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave/Autoritetit Kontraktues, i cili ka kryer vlerësimin në përputhje me dokumentacionin e tenderit dhe kriteret e përcaktuara në FDT. Duke u bazuar në nenin 6 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili përcakton parimin e profesionalizmit dhe përgjegjësisë së autoriteteve kontraktuese gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit publik,

si dhe duke marrë parasysh se nga shqyrtimi nuk janë vërejtur shkelje të natyrës thelbësore që do të cenonin ligjshmërinë e vendimit të Komisionit të Vlerësimit, pretendimi ankimor mund të konsiderohet pjesërisht i bazuar. Megjithatë, veprimet e ndërmarra nga Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni i Vlerësimit janë në përputhje me dispozitat ligjore dhe parimet e prokurimit publik.

Përgjigje në pretendimin ankimor 5: Në cilësinë e ekspertit shqyrtues të prokurimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, sqarojmë se pretendimi ankimor i ngritur nga operatori ekonomik ankues nuk qëndron. Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, në funksion të përmbushjes së kërkesës së dosjes së tenderit lidhur me lokacionin për mbajtje dhe ruajtje të automjeteve të tërhequra, ka ofruar si dëshmi kontratën noteriale LRP.nr.2099/2025, Ref.nr.465/2025, përmes së cilës vërehet se pronësia mbi parcelën e identifikuar është transferuar përmes noterit në pronësi të operatorit ekonomik në fjalë. Për tej kësaj lokacioni i cili është prezantuar është po të njejten konmu qka e ben edhe më të letë verifikimn e saj.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor 6: Në cilësinë e ekspertit shqyrtues të prokurimit, me datë 14.11.2025 kam kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktues (AK), lidhur me faturën e paraqitur vrenjtur se fatura në fjalë është e nënshkruar dhe e vulosur nga operatori ekonomik në cilësinë e shitësit. Përveç kësaj, operatori ekonomik ka ofruar edhe materiale plotësuese (fotografi) që vërtetojnë të dhënat e faturës. Duke u bazuar në dokumentacionin dhe sqarimet e dorëzuara, si dhe duke marrë parasysh se vlerësimi i këtij dokumenti është kompetencë dhe përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues, rezulton se pretendimi ankimor i paraqitur në këtë pikë është i pabazuar dhe nuk qëndron.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor 7: Bazuar në përmbajtjen e dosjes së aktivitetit të prokurimit dhe në kërkesat e përcaktuara qartë në dokumentet e tenderit, lidhur me këtë pretendim ankimor është ngritur çështja për përmbushjen e kriterit: *Kërkesa: Operatori Ekonomik duhet të ketë së paku 2 shoferë me kategoritë përkatëse dhe 2 roje në lokacion, ndërsa si dëshmi është kërkuar: Për shoferët: patentë-shoferët (kopje) të kategorive përkatëse; Për stafin tjetër: kontratat apo parakontratat që dëshmojnë angazhimin për këtë projekt.* Në funksion të këtij pretendimi, në cilësinë e ekspertit shqyrtues, me datë 14.11.2025 kam kërkuar sqarime shtesë nga Autoriteti Kontraktues (AK). Po të njëjtën ditë, AK ka ofruar sqarimet e kërkuara dhe ka dorëzuar të gjitha kontratat e punonjësve, përfshirë edhe kontratën për M.B., e cila rezulton e nënshkruar dhe e vulosur nga të dy palët, duke plotësuar kështu kërkesat e dosjes së tenderit. Sa i përket pjesës që lidhet me dokumentet e ATK-së, e cila është ngritur si pretendim nga ankuesi, konstatohet se një kërkesë e tillë nuk ka qenë e paraparë nga Autoriteti Kontraktues, Për më tepër, përgjegjësinë për deklaratimet e stafit e mban vetë operatori ekonomik, ashtu siç përcaktohet në legjislacionin relevant. Në bazë të sqarimeve më lart pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor 8: Sa i përket pretendimit ankimor të ngritur lidhur me për zgjedhjen nga Autoriteti Kontraktues të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, i cili ka ofruar përqindjen më të favorshme për Komunën e Klinës, sqarojmë se ky pretendim është trajtuar dhe sqaruar plotësisht edhe në Pretendimin Ankimor nr. 1.

Sa i përket pretendimit ankimor nr. 9: Sqaroj se çështjet e ngritura nga operatori ekonomik ankues janë trajtuar dhe janë përgjigjur tashmë në pretendimet paraprake. Lidhur me pjesën ku ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues “nuk ka dhënë përgjigje adekuate”, vlen të theksohet se AK me datë 21.10.2025 ka dhënë përgjigje zyrtare me vendim ndaj kërkesës suaj

për rishqyrtim, duke adresuar secilën nga çështjet e ngritura nga OE ankues. Cilësia, gjerësia ose mënyra e formulimit të përgjigjeve të AK-së nuk mund të interpretohet si mos-përgjigje apo si shkelje procedurale, për sa kohë që AK e ka përmbushur detyrimin ligjor për t'iu përgjigjur kërkesës së paraqitur nga OE, në afatin dhe formën e kërkuar sipas LPP-së. Për këtë arsye, pretendimi se “AK nuk ka dhënë përgjigje adekuate” është i pabazuar, pasi: përgjigja nga AK ekziston, është dhënë brenda afatit ligjor, adreson pikat e ngritura nga OE dhe përmbush standardin minimal ligjor të kërkuar në procedurat e rishqyrtimit administrativ. Në cilësinë e ekspertit shqyrtues vërejmë se AK ka vepruar në përputhje me detyrimet e tij ligjore, ndërsa vlerësimi subjektiv i OE-së mbi “adekuatësinë” e përgjigjes nuk mund të përdoret si bazë për konstatimin e ndonjë shkeljeje apo parregullsie. Ndërsa pjesa tjetër e pretendimit është sqaruar në pretendimet e lartë shënuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të ankandit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e ankandit publik dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Eco Amari” SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të ankandit publik. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar OE-të. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “Eco Amari” SH.P.K, janë të pa bazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e ankandit publik si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pa bazuara, të paraqitura ndaj vendimit të autoritetit kontraktues, për aktivitetin e prokurimit.

Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar në raportin e ekspertit, Paneli shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimit-rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues, sipas të cilit pretendimet ankimore të ankuesit janë vlerësuar si të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe raportin e ekspertit shqyrtues me rekomandim, ka gjetur se ankesa e operatorit ekonomik OE “Eco Amari” SH.P.K të refuzohet si e bazuar dhe mbet në fuqi, vendimi i AK- Komuna Klinë, për aktivitetin e ankandit publik.

Paneli shqyrtues përfundimisht vendosi të refuzohet ankesa e OE “Eco Amari” SH.P.K, dhe mbet në fuqi, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur aktivitetin e ankandit publik me titull “Shprehje interesi – shërbime të tërheqjes apo bllokimit të automjeteve sipas urdhëresës së Policisë së Kosovës ” me numër: 634-25-8413-2-6-10, inicuar nga autoriteti kontraktues AK-Komuna Klinë.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlerësimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2025/1050, se gjatë zhvillimit të kësaj procedure të ankandit publik, autoriteti kontraktues- Komuna Klinë, në procesin e vendimarrjes, ka zbatuar dispozitat ligjore të Ligjit Prokurimit Publik dhe të Rregullorës së Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj” lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankesës të OE “Eco Amari” SH.P.K vendosi të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**
- **OE - Eco Amari SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: